



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 22 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Matjes të Shpërndarjes të datës 17 dhjetor 2013,

**në seancën e mbajtur me datë 12 mars 2014, nxori këtë:**

**V E N D I M**

**I Aprovohen amendamentimet e Kodit të Matjes së Shpërndarjes**

**Arsyetim**

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 17 dhjetor 2013 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Matjes së Shpërndarjes të harmonizuar me ndryshimet në legjislacionin primar dhe ndryshimet tjera të ndodhura. Në këtë kuadër janë bërë edhe disa përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit. ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO.

Me datë 29 shkurt 2012 është nënshkruar Marrëveshja në mes të KEK dhe KOSTT për transferin e aseteve të bazuar në vendimin Nr. 10/29 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pas kësaj marrëveshje, ZRRE me datë 15 qershor 2012 ka nxjerr vendimin Nr. V\_403\_2012 me të cilin aprovohet transferi i aseteve 400/220/110 kV duke përfshirë edhe transformatorët 220/35/10 (20) kV, si dhe tokave, ndërtesave, pajisjeve ndihmëse dhe të punësuarve nga KEK sh.a në KOSTT sh.a. Është e nevojshme që ndryshimet që dalin nga kjo marrëveshje të inkorporohen në Kodin e Matjes së Shpërndarjes.

Pas këtyre zhvillimeve, KQKO ka amendamentuar dokumentin në harmoni me ndryshimet ligjore dhe transferin e aseteve, dhe me datë 17 dhjetor 2013 ka bërë kërkesë zyrtare për Arovimin e amendamentimit të Kodit të Matjes së Shpërndarjes.

Pas vlerësimit të kërkesës, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë amendamentimin e Kodit të Shpërndarjes. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Matjes së Shpërndarjes do të mbesin në fuqi.



II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar